

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A- 081/14

**Prishtinë,
10 Dhjetor 2014**

Në çështjen juridike të:

A. D.

Mitrovicë

Pala ankuese

kundër

N/A

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini , anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 10678), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 10 Dhjetor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e A. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013, të datës 21 gusht 2013.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013, i datës 21 gusht 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KP10678.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 24 nëntor 2006, A. D. (më tutje: paraqitësi i kërkeses) ka paraqitur një kërkesë duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës nr. 397/1 me sipërfaqe prej 00.10.59 ha (më tutje: prona), që ndodhet në Komunën e Istogut, zona kadastrale Gurrakoc.
2. Në kërkesë, A.D.nuk ka pretenduar se posedimi i pronës së kërkuar ishte humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën 1998/1999; duke mos cekur ndonjë datë të humbjes së posedimit. Në vend të kësaj, Damjanović pretendon se ishte bashkëpronarë i pronës që ishte nacionalizuar në vitin 1954 dhe i ishte dhënë në shfrytëzim Ndërmarrjes Publike "Dubrava" e cila kishte ndërtuar disa objekte afariste në të.
3. Për ta mbështetur kërkesën, ai ka paraqitur, *inter alia*,

Fletën Poseduese nr. 351 të lëshuar nga Instituti Gjeodezik i Serbisë, Qendra për Kadastër të Pronave të Paluajtshme në Istog më 25 gusht 2004. Sipas fletës poseduese, prona ka qenë në bashkëpronësi të A. D. së bashku me vëllezërit, motrat, dhe nënën e tij.
4. Identifikimi i pronës së kërkuar është bërë më 14 nëntor 2008 dhe e pronën e pasqyron si një oborr, shtëpi e shkatërruar tërësisht (sipas Fletës Poseduese prona përbëhet nga shtëpia, oborri, dhe livadhi) dhe livadhi që nuk është e uzurpuar. Ekipi i AKP-së ishte i shoqëruar nga R. P. i cili ka deklaruar se familja D. nuk ka banuar në pronën e identifikuar që nga viti 1950.

5. Pasi që asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa ka mbetur e pa kontestuar.
6. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPCC/D/R/215/2013, e ka hedhur poshtë kërkesën. Në paragrafin 23 të vendimit, që aplikohet specifikisht për kërkesën, theksohet se në bazë të llojeve të ndryshme të dokumenteve të verifikuara, që janë dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës apo që janë marrë nga Sekretaria Ekzekutive *ex officio*, ose bazuar në deklaratën e vet paraqitësit të kërkesës, paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të demonstrojë se kërkesa e tij ka të bëjë me rrethanat që ndërliken drejtpërdrejtë apo që burojnë nga konflikti i viteve 1998-1999. Paraqitësi i kërkesës kurrë nuk e ka pasur posedimin mbi pronën; rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë mandatit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.
7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 20 dhjetor 2013, i cila ankesën e ka paraqitur më 14 janar 2014.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese cek se ai është refugjat nga Spliti, i regjistruar në Komunën e Istogut me vendbanim në shtëpinë e tij familjare në Gurrakoc. Shtëpia ishte trashëguar nga prindërit e tij. Sipas palës ankuese, pas vdekjes së prindërve, njëri nga vëllezërit e tij që jeton në Mitrovicë në mënyrë të vazhdueshme ka vizituar, mirëmbajtur, dhe investuar në shtëpi deri në kohën kur pala ankuese është vendosur aty, në vitin 1999, dhe ishte shpërngulur. Pala ankuese mëton se, si person që është i dëmtuar, atij duhet t'i jepet kompensim, nëse jo menjëherë, atëherë kurdo që është e mundur.
9. Pala ankuese më tej ka paraqitur:
 - Kontratën nr.191 e lidhur më 19 tetor 1998, ndërmjet Komisionit Komunal të Istogut (si sigurues i fondeve) dhe palës ankuese (si shfrytëzuese e fondeve). Sipas kontratës, komisioni i siguron fonde palës ankuese për ndërtimin e shtëpisë. Megjithatë, kontrata nuk përmban specifikime lidhur me lokacionin apo numrin e ngastrës në të cilën do të ndërtohet shtëpia.
 - Kontratën nr.233 të datës 2 dhjetor 1998, ndërmjet Komisionit Komunal të Istogut dhe palës ankuese për ndërtimin e shtëpisë. Neni 2 i kontratës specifikon se fondet duhet të shfrytëzohen deri më 1 qershor 1999.

- Çertifikatën nr. 273 të lëshuar nga Kryqi i Kuq, Komuna e Podgoricës (Mali i zi) më 6 gusht 1999, Çertifikatën nr.1659 të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Barit (Mali i zi) më 17 gusht 1999, që tregon se pala ankuese ka qenë refugjatë nga Komuna e Istogut e cila është regjistruar në Kryqin e Kuq në Podgoricë (Mali i zi), më pas ajo është transferuar në Bari (Mali i zi) dhe në fund ajo ka kaluar në Mitrovicë sipas Çertifikatës nr.101 të datës 6 prill 2009.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa është paraqitur brenda 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme ka juridiksion mbi ankesën kundër vendimit të KKPK-së. Ankesa është e pranueshme.

Meritat e ankesës

11. Çështja për t'u konsideruar në këtë lëndë është nëse KKPK ka pasur juridiksion për ta shqyrtuar kërkesën e A. D. të paraqitur në AKP në vitin 2006.
12. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK ka kompetencë të zgjidh kërkesat që ndërlidhen me konfliktin që kanë të bëjnë me rrethanat që ndërlidhen apo burojnë nga konflikti i armatosur të viteve 1998. Pra, paraqitësi i kërkesës duhet ta dëshmojë jo vetëm të drejtën pronësore mbi një pronë të paluajtshme private por gjithashtu të provoj se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo burojnë nga konflikti i armatosur. Të dy kushtet duhet të plotësohen.
13. Në rastin e tanishëm, humbja e posedimit ka ndodhur në vitin 1954 (vet pala ankuese e pohon këtë fakt) si rezultat i nacionalizimit në vitin 1954. Sipas D, atyre iu është premtuar një tokë si kompensim, por kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë. Është e qartë se kërkesa ka të bëjë me një kontest që ka filluar para vitit 1998, dhe se ajo nuk ka të bëjë dhe as nuk rrjedh nga konflikti i armatosur të viteve 1998/1999. Fakti se ai ka qenë refugjat nuk mjafton për të dëshmuar se ai e ka poseduar pronën para konfliktit dhe kishte humbur atë për shkak të rrethanave të konfliktit të armatosur. Dokumentet në

dosje dhe pretendimi i tij gjithashtu provojnë se humbja e posedimit ka ndodhur shumë më herët se konflikti si pasojë e nacionalizimit. Interesimi i tij apo vëllezërve të tij për ta ri poseduar pronën meqë nuk ishte dhënë kompensimi, në kundërshtim me premtimet e dhëna, nuk dëshmon të drejtën pronësore mbi pronën apo posedimin e tij ligjor mbi pronën.

14. KKKPK ka hedhur poshtë kërkesën me arsyetimin se nuk ka pasur juridiksion për të vendosur mbi meritat e kërkesës, pasi që pala ankuese nuk ka arritur të dëshmojë se kërkesa e tij përfshin rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo burojnë nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999.
15. Në ankesë thuhet se pala ankuese ka kërkuar kompensim që nuk përkon me kërkesën që ajo e ka paraqitur pranë AKP-së. Aty qartë thuhet se është kërkesë për ri-posedim, nuk përmendet kompensimi.
16. Për herë të parë me ankesën, pala ankuese thekson se kërkesa e tij ka të bëjë me kompensim; megjithatë, kjo nuk mbështetet me përmbajtjen e shkresave të lëndës në shkallën e parë, as me kërkesën e as me ndonjë dokument apo deklaratë tjetër në dosje. Prandaj, pohimet në ankesë duhet të trajtohen vetëm si argumente mbrojtëse. Gjykata, as në shkallën e parë e as në të dytën, nuk mund të bëjë shqyrtim *plus petitum*, Gjykata vendos vetëm përmbrenda sferës së kërkesës që është dorëzuar – argumenti sipas nenit 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që zbatohet *mutatis mutandis* sipas nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079. Për më tepër, as Komisioni e as Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme nuk e kanë mandatin të marrin vendime për kërkesat për kompensim lidhur me pronën e paluajtshme private të shkatërruar. Vet, Ligji Nr. 03/L-079 nuk parasheh mekanizëm kompensimi për pronën e shkatërruar.
17. Lidhur me provat e reja të paraqitura nga pala ankuese vetëm Gjykatës në shkallën e apelit, pa dhënë ndonjë arsyetim për ta justifikuar mosdorëzimin e provave të njëjta para shkallës së parë:
Neni 12.11 i Ligjit nr. 03/L-079 parasheh që “*Faktet e reja dhe provat materiale të paraqitura nga ndonjëra palë në ankese nuk do të pranohen dhe shqyrtohen nga Gjykata Supreme, përveç nëse nuk provohet se ato fakte dhe provat pala në fjalë nuk ka mundur t’i di në mënyrë të arsyeshme*”.
18. Për më tepër, provat e dorëzuara nuk kanë të bëjnë me pronën e kërkuar; prandaj, ato nuk merren parasysh.

19. Rrjedhimisht, ankesa sipas nenit 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 duhet të refuzohet si e pabazuar dhe konfirmohet vendimi i KKPK-së sa i përket lëndës për të cilën është dashur të vendoset me këtë aktgjykim (KPA10678).
20. Për shkak se KKPK dhe Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme nuk kanë juridiksion në këtë lëndë, nuk i kanë shqyrtuar meritat e lëndës. Ky aktgjykim është pa paragjykim mbi të drejtën e palës ankuese për të ndjekur të drejtat e tij në gjykatën kompetente.

Këshillë ligjore

21. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini , Gjyqtar

Urs Nufer, EULEX Referent i EULEX-it